

KISHA E JEZU KRISHTIT E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME  
ZYRA E PRESIDENCËS SË PARË  
47 EAST SOUTH TEMPLE STREET, SALT LAKE CITY, UTAH 84150-1200

26 mars 2016

Drejtuar: Autoriteteve të Përgjithshme; Të Shtatëdhjetëve Zonalë; Presidentëve të Kunjeve, të Misioneve dhe të Distrikteve; Peshkopëve dhe Presidentëve të Degëve dhe Presidencave të Filloreve, të Të Rejave dhe Shoqatave të Ndhmës të Kunjeve e të Lagjeve

*(Të lexohet në këshillat e kunjeve, lagjeve dhe degëve)*

Të Dashur Vëllezër e Motra:

“Isha i Huaj”: Ndhma ndaj Refugjatëve

Ne u kujtojmë shenjtoreve të ditëve të mëvonshme në mbarë botën se një prej parimeve themelore të ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit është “t’u j[apim] nga pasuria [jonë] të varfërve, çdo njeri sipas asaj që ka, . . . t’u j[apim] ndihmë atyre qoftë shpirtërisht, ashtu edhe materialisht, sipas nevojave të tyre” (Mosia 4:26).

Në përputhje me letrën tonë të datës 27 tetor 2015, presidencat e përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës, të Të Rejave dhe të Fillores i ftojnë gratë e të gjitha moshave që të bashkohen për të ndihmuar refugjatët në komunitetet e tyre vendore.


Nisma e motrave është titulluar “Isha i Huaj” (shih Mateu 25:35; Levitiku 19:34). Nisma “Isha i Huaj” u jep motrave një mënyrë për të shërbyer si individë, familje dhe organizata e për t’u ofruar shoqëri, këshillime dhe shërbime të tjera si të Krishtit, refugjatëve mes nesh. Për hollësi të mëtejshme, shihni letrën bashkëngjitur.


Motrat mund të marrin pjesë në këtë nismë kur ua lejon koha dhe rrethanat, duke u siguruar se nga askush nuk pritet të “vrapojë më shpejt sesa a[jo] ka fuqi” dhe se të gjitha këto “gjëra të . . . bë[hen] në urtësi dhe rregull” (Mosia 4:27).

Zoti ju bekoftë ndërsa jepni shërbim ndaj njerëzve në nevojë.

Sinqerisht tuajt,

  
\_\_\_\_\_

  
\_\_\_\_\_

  
\_\_\_\_\_

Presidenca e Parë

KISHA E  
JEZU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME

26 mars 2016

(Të shpërndahet në mbledhjet e Shoqatës së Ndhmës, të Të Rejave e të Filllores)


Të dashura Motra:


Nisma ndihmëtare “Isha i Huaj” përqendrohet te shërbimi ndaj refugjatëve në lagjet dhe komunitetet tona vendore. Kjo është veçse një nga mënyrat e shumta me të cilat gratë, të rejat dhe vajzat në Shoqatën e Ndhmës, te Të Rejat e te Fillorja, mund të ngrenë dhe të bekojnë ata në nevojë (shih Mateu 25:35; Levitiku 19:34).


1. **Kush mund të marrë pjesë?** Kushdo që ka dëshirë, duke rikujtuar se asnjë motër nuk është e detyruar dhe se asnjëra nuk ka përse shërben në kurriz të familjes si dhe të përgjegjësive të tjera (shih Mosia 4:27). Tek ata që shërbejnë mund të përfshihet sa vijon:
  - Një individ
  - Një familje
  - Një grup i Shoqatës së Ndhmës, i të Rejave ose i Filllores (shih *Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]* [2010] 9.4.2, 10.8, 11.5.2)
  - Një lagje ose një organizatë e komunitetit
2. **Si mund të marrin pjesë motrat?** Motrat nxiten që të kërkojnë plot lutje mundësi për të shërbyer dhe të marrin në shqyrtim që të gjejnë komunitete vendore dhe organizata të besueshme për përkrahje. Faqja e internetit [IWasAStranger.lds.org](http://IWasAStranger.lds.org) mund të japë ide.
3. **Si mund t'i tregojnë motrat përvojat e tyre?** Motrat mund t'i tregojnë përvojat e tyre nëpërmjet adresës së postës elektronike [IWasAStranger@ldschurch.org](mailto:IWasAStranger@ldschurch.org).

Ne shpresojmë se që të gjithë do t'i kuptojnë bekimet e përjetshme të shërbimit si të Krishtit, duke mos qenë harrues në mikpritjen e të huajve, sepse disa kanë qenë mikpritës ndaj engjëjve pa e kuptuar (shih Hebrejve 13:2).

Sinqerisht tuajt,

  
Presidentja e Përgjithshme e  
Shoqatës së Ndhmës

  
Presidentja e Përgjithshme e Të  
Rejave

  
Presidentja e Përgjithshme e  
Filllores